



PK SH.A

PK SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosova D.Ö.

Nr./No./Br. 01-889/116
Data/Date/Datum 30-03-2016
PRISHTINË-PRISTINA-PRISTINA



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosovo
Tax Administration of Kosovo

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT

NDËRMJET

POSTËS SË KOSOVËS sh.a

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije Ministry of Finance	
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo	
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE	
Org. Unit	No. Prot. Br. Prot. Prot. No. <u>09-06-196</u>
Nr. faqeje Broj stranica No. pages:	Data Datum Date: <u>30.03.16</u>
Hyresce PRISHTINË: A	

DHE

ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS

Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi (tani e tutje: Marrëveshja) është lidhur ndërmjet palëve nënshkruese duke pasur parasysh dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-173 për Shërbimet Postare si dhe Ligjin bazik Nr. 03/L-222, për Administratën Tatimore dhe Procedurat i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe 04/L-223.

Neni 1

Palët në Marrëveshje

1. Kompania e Postës së Kosovës Sh.A. (**Kryerësi i Shërbimeve**) e regjistruar ne regjistrin e bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, me numër të regjistrimit të biznesit 70847701, me seli qendrore ne lagjen Dardania, p. n. në Prishtinë, Kosovë, e përfaqësuar nga Sejdi Hoxha, Kryeshef Ekzekutiv (“PK sh.a”), dhe
2. Administrata Tatimore e Kosovës (**Kërkuesi i Shërbimeve**), si Autoritet Ekzekutiv me autonomi të plotë operationale në kuadër te Ministrisë së Financave, e cila është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve tatimore dhe mbledhjen e tatimeve sipas Ligjit bazik Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe 04/L-223, e përfaqësuar nga Sakip Imeri, Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje është që përmes bashkëpunimit ndër institucional të bëhet realizimi i shërbimeve postare (dërgesat postare) nga ana e Postës së Kosovës sh.a. në cilësi të Kryerësit të Shërbimeve dhe Administratës Tatimore të Kosovës, si Autoritet Ekzekutiv në cilësi të Kërkuesit të shërbimeve postare lidhur me implementimin e projektit për “Mbledhjen dhe Dorëzimin e Kuponëve Fiskal”, nga ana e të gjithë

qytetareve, siç është e specifikuar në dispozitat e nenit 26 të Udhëzimit Administrativ MF. Nr. 01/2015, për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike dhe Sistemeve Fiskale.

Neni 3 Fushëveprimi

Fushëveprimi i kësaj marrëveshje ndërlidhet me pranimin, bartjen dhe shpërndarjen e plikove të qytetareve, me kupona fiskal.

Neni 4 Zotimi i palëve në marrëveshje

1. Palët nënshkruese janë dakorduar që objekt i kësaj marrëveshje të jetë pranimi, shpërndarja dhe dorëzimi i plikove me kupona fiskal në adresat e përcaktuara me këtë nen.

1.1. Kryerësi i shërbimeve me këtë marrëveshje merr mbi vete obligimin që të bëjë pranimin, shpërndarjen dhe dorëzimin e të gjitha plikove me kupona fiskalë të pranuar nga qytetaret.

1.2. Kryerësi i Shërbimeve obligohet që të gjitha plikot e pranuar sipas kësaj marrëveshje brenda afatit prej dy (2) deri pesë (5) ditë t'i shpërndajë në Zyrat Regjionale përkatëse të Administratës Tatimore të Kosovës, si ne vijim: Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë, Gjilan dhe Ferizaj.

1.3. Kryerësi i Shërbimeve obligohet që me rastin e pranimit të plikove me kuponë fiskal të bëjë paraprakisht verifikimin e aplikuesit në sistem për të vërtetuar se të dhënat në pliko janë në përputhje me të dhënat në sistem dhe tek pastaj mund të evidenton regjistrimin e plikove në sistem. Të gjithë numrat e plikove duhet të verifikohen në sistem nga zyrtari i Postës, para se të kryhet pranimi dhe regjistrimi në sistem i plikove.

1.4. Asnjë pliko me kuponë fiskal nuk duhet të pranohet nga zyrtarët e Postës, nëse nuk është kryer paraprakisht aplikimi përmes sistemit nga pala e interesuar.

1.5. Ç'ështëja e kompensimit nga ana e klientëve për shërbimet postare (pranimin, shpërndarjen dhe dorëzimin e kuponëve fiskal në Zyrat Regjionale përkatëse të ATK-së) të ofruara nga ana e Postës së Kosovës, është e rregulluar sipas tarifave të rregullta të ARKEP-it.

1.6. Palët zotohen që në vazhdimësi të hulumtojnë pikat tjera strategjike për bashkëpunim afatgjatë dhe të zgjerojnë listën e bashkëpunimit afarist dhe në interes të ndërsjellët.

1.7. Kryerësi i shërbimeve do të jetë përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar mbi dërgesat për shkak të akteve apo mos veprimeve të tij nga pakujdesia, keq shfrytëzimi ose keqpërdorimi prej anëtarëve të personelit të tij.

Neni 5 Obligimet e dyanshme të palëve kontraktuese

1. Palët obligohen që së bashku të bashkëpunojnë dhe koordinojnë aktivitetet për implementimin, zbatimin, mbikëqyrjen dhe finalizimin e kësaj marrëveshje të mirëkuptimit.

2. Palët do të caktojnë nga një koordinator si person kontaktues i cili do të përkujdeset drejtpërdrejt për implantimin në praktikë të kësaj marrëveshje të mirëkuptimit.

Neni 6 Zbatimi i Marrëveshjes

1.1. Kjo marrëveshje fillon se zbatuari me rastin e nënshkrimit nga të dyja palët dhe vazhdon për një kohë të pacaktuar.

1.2. Secila pale kontraktuese mund të ndërpresë njëanshëm marrëveshjen për kryerjen e shërbimeve postare brenda kohëzgjatjes së marrëveshjes, kurdo që ajo e vlerëson të nevojshme se kjo marrëveshje ka efekte negative afariste.

1.3. Palët me rastin e zgjidhjes së kësaj marrëveshjeje janë të obliguara që paraprakisht në një afat prej 30 ditësh të njoftojnë me shkrim njëra tjetrën se nuk janë të interesuara të vazhdojnë bashkëpunim.

1.4. Çdo çështje tjetër e pa trajtuar në këtë marrëveshje do të zgjidhet në pajtueshmëri të palëve në përputhje me legjislacionin tatimor dhe legjislacionin mbi shërbimet postare.

Neni 7 Ndryshimi, nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1.1. Kjo marrëveshje mirëkuptimi iu është referuar palëve nënshkruese dhe nuk mund të transferohet të palët e tjera.

1.2. Plotësimi dhe ndryshimi i kësaj marrëveshjeje mund të bëhet vetëm me pajtimin e shprehur me shkrim nga të dy palët

1.3. Kjo marrëveshje është e nënshkruar nga personat e autorizuar dhe është e hartuar në kopje katër (4) të njëjta, nga dy kopje për secilën nga palët nënshkruese.

1.4. Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të palëve.

Nënshkruesit

Posta e Kosovës Sh.A.


Sejdi Hoxha
Kryeshef Ekzekutiv

Datë: 30/03/2016

Administrata Tatimore e Kosovës


Sakip Imeri
Drejtor i Përgjithshëm

Datë: 30/3/2016